


FEDERATA E SHAHUT E KOSOVËS

Raporti i Auditorit të Pavarur dhe Pasqyrat financiare për vitin
që përfundon me 31 dhjetor 2024



Përmbajtja	Faqe
Raporti i Auditorit të Pavarur	3-4
Pasqyra e burimit dhe përdorimit të fondeve	5
Pasqyra e pozitës financiare	6
Pasqyra e ndryshimeve në bilancin e fondeve	7
Pasqyra e rrjedhjes së arkës	8
Shënime për pasqyrat financiare	9-18



RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR

Për Bordin dhe Menaxhmentin e Federatës së Shahut të Kosovës

Ne kemi audituar Pasqyrën e bashkangjitur të burimeve të fondeve dhe përdorimit të tyre dhe Pasqyrën e pozitës financiare ("Pasqyrat") të "Federatës së Shahut të Kosovës" ("FSHeK") si dhe një përmbledhje të politikave kontabël dhe shënimeve tjera shpjeguese për vitin që ka përfunduar me 31 dhjetor 2024.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, të hyrat e mbledhura dhe shpenzimet e paguara nga Federata e Shahut e Kosovës, poziten financiare si dhe rrjedhën e parasë për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2024, në përputhje me Politikat e kontabilitetit të sqaruara në pikën 2.

Baza për Opinionin

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen përgjegjësitë e audituesit për pasqyrat financiare.

Ne jemi të pavarur nga kompania në pajtueshmëri me Kodin e Etikës për Kontabilistët Profesionist të Bordit Ndërkombëtar të Standardeve të Etikës (Kodi i IESBA) së bashku me kërkesat që janë relevante gjatë auditimit tonë të pasqyrave financiare në Kosovë, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë tona tjera etike në pajtueshmëri me këto kërkesa dhe Kodin e IESBA.

Ne besojmë se evidanca e përfutur e auditimit është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të ofruar bazë për opinion.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe personave të ngarkuar me qeverisjen e pasqyrave financiare

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me Standardet e Raportimit Financiar të zbatueshme në Kosovë, me Politikat e sqaruara në pikën 2 dhe për ato kontrole të brendshme që menaxhmenti i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Në përgatitjen e pasqyrave financiare, menaxhmenti është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e FSHeK-së për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likujdojë FSHeK-në ose të ndërpres aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër. Ata që janë të ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të FSHeK-së.



Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë të përftojme siguri të arsyeshme nëse pasqyra e pranimeve dhe disbursimeve si tërësi nuk përmban anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të japim një raport të auditorit që përfshinë opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është nivel i lartë i sigurisë, por nuk është garancion se auditimi i kryer sipas SNA gjithmonë do të zbulojë anomali materiale kur ekzistojnë ato. Anomalitë mund të paraqiten nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen që janë materiale nëse, individualisht ose të grumbulluara, ato mund të ndikojnë në mënyrë të arsyeshme në vendimin që marrin përdoruesit bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në pajtueshmëri me SNA, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticizmin profesional përgjatë tërë auditimit.

Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale të pasqyrës së pranimeve dhe disbursimeve, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, projektojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit si përgjigje ndaj këtyre rreziqeve dhe përftojme evidenca të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të na ofruar bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të anomalive materiale për shkak të mashtrimit është më i lartë se ai i shkaktuar nga gabimet, pasi që mashtrimi mund të përfshijë marrëveshjet e fshehta, falsifikimin, lënjen anash me qëllim, keqinterpretimin ose anashkalimin e kontrolleve.
- Përftojme njohuri mbi kontrollet e brendshme që janë relevante për auditimin në mënyrë që të projektojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme për ato rrethana, por jo me qëllim të japim një opinion mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të FSHeK-së.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të përdorura të kontabilitetit dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kontabël dhe shpalosjeve përkatëse nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrës së pranimeve dhe disbursimeve, përfshirë shpalosjet, dhe nëse pasqyra e pranimeve dhe disbursimeve përfaqëson transaksionet dhe ngjarjet themelore në një mënyrë që arrin prezantimin e drejtë.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen, në mes tjerash edhe lidhur me fushëveprimin e planifikuar, kohën e auditimit dhe gjetjet domethënëse të auditimit, përfshirë çfardo mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm të identifikuar gjatë auditimit tonë.

Lulzim Krasniqi, Auditor LIGJOR, CertIFR, VLP
Partner, QUATRA AUDIT Int. LLC

Prishtinë, 27 mars 2025

P: +383 (0) 44 377 873 ♦ E: lulzimkrasniqi@gmail.com
A: Sheshi Nëna Terezë, H1, Nr.2, Prishtinë, Kosovë
Licenca KKRF Nr. 80 ♦ Nr. Scaak: 2088

FEDERATA E SHAHUT E KOSOVËS
PASQYRA E BURIMIT DHE PËRDORIMIT TË FONDEVE
Për vitin që përfundoi më 31 dhjetor 2024
(Shumat në Euro)

	Shënime	2024	2023
Të hyrat nga MKRS	3	138,510	137,568
Të hyrat nga donacionet/projektet/sponzorizimet	3	-	84,087
Të hyrat tjera	3	22,450	6,500
Gjithsej të hyrat		160,960	228,156
Shpenzimet e personelit	4	(12,172)	(5,670)
Shpenzimet administrative dhe operative	5	(67,199)	(12,237)
Shpenzimet për organizim të garave	6	(111,787)	(59,656)
Shpenzimet për shpërblime dhe klube rajonale	7	(33,325)	(47,458)
Shpenzimet e promovimit të shahut	8	-	(20,650)
Shpenzimet e sponzorizimit-BpB	9	-	(15,053)
Gjithsej shpenzimet		(224,484)	(160,724)
Teprica/Mungesa e fondeve të mbetura		(63,524)	67,432

Raporti financiar është aprovuar dhe nënshkruar nga menaxhmenti i OJQ-së më datë 01 Mars 2025.

Armend Budima, Kryetar _____ datë _____
(nënshkrimi)

Burhanudin Misini, Skretar _____ datë _____
(nënshkrimi)

FEDERATA E SHAHUT E KOSOVËS
PASQYRA E POZITËS FINANCIARE
Më 31 dhjetor 2024
(Shumat ne Euro)

	Shënime	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
PASURITË			
Paraja e gatshme	10	953	58,796
Pasuri rrjedhës të tjera		-	-
GJITHSEJT PASURITË		953	58,796
FONDET DHE DETYRIMET			
Detyrimet			
Llogaritë e pagueshme	11	29,154	22,703
Detyrimet tjera afatshkurtëra	12	4,212	4,981
Gjithsej detyrimet		33,366	27,684
Fondet			
Teprica(mungesa) e akumuluar		-32,413	31,111
Gjithsej fondet		-32,413	31,111
GJITHSEJT FONDET DHE DETYRIMET		953	58,796

FEDERATA E SHAHUT E KOSOVËS**PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË BILANCIN E FONDEVE**

Për vitin që përfundoi më 31 dhjetor 2024

(Shumat në Euro)

	Bilanci i Fondeve 31 dhjetor 2024	Bilanci i Fondeve 31 dhjetor 2023
Bilanci në fillim të vitit	31,111	(36,321)
Teprica (Mungesa) e fondeve gjate vitit	(63,524)	67,432
Korigjimet nga periudhat paraprake	-	-
Të hyrat tjera gjithëpërfshirëse	-	-
Bilanci në fund të vitit	(32,413)	31,111

FEDERATA E SHAHUT E KOSOVËS
PASQYRA E RRJEDHJES SË ARKËS
Për vitin që përfundoi më 31 dhjetor 2024
(Shumat në Euro)

	Shënime	2024	2023
Teprica (Mungesa) e fondeve e vitit		(63,524)	67,432
Korrigjimet:		-	-
Fitimi para ndryshimit në asetet dhe obligimet operative		(63,524)	67,432
(Rritja)/Zvogëlimi në llogaritë e arkëtueshme		-	-
Rritja/(Zvogëlimi) në llogaritë e pageshme		6,451	3,983
Rritja /(Zvogëlimi) në detyrimet tjera		(770)	(14,444)
Paraja e përdorur në operacionet		5,681	(10,461)
Neto rritja e parasë dhe ekuivalentëve		(57,843)	56,971
Paraja dhe ekuivalentët e parasë në fillim të vitit		58,796	1,825
Paraja dhe ekuivalentët e parasë në fund të vitit	10	953	58,796

Shënimet shoqëruese nga 3 deri 14 janë pjesë integrale të pasqyrave financiare

FEDERATA E SHAHUT E KOSOVËS

SHËNIMET E PASQYRAVE FINANCIARE

Për vitin që përfundoi më 31 dhjetor 2024

(Shumat në Euro)

1. INFORMATA TË PËRGJITHSHME

OJQ "FSHeK" është themeluar si organizatë joqeveritare sipas Ligji Nr. 04/L-57, Neni 9 për Lirinë e Asociimit në Organizatat Joqeveritare në Republikën e Kosovës.

- Organizata quhet "FEDERATA E SHAHUT E KOSOVËS"

- Ajo njihet edhe si OJQ "FSHeK"

- Organizata është shoqatë jofitimprurëse, sipas definimit të dhënë në nenin 5.2 dhe 6 të Ligjit Nr.04/L-57 për Lirinë e Asociimit në Organizatat Joqeveritare në Republikën e Kosovës.

Data e regjistrimit:	22 Shkurt 2001
NRB:	5100600-3
NRF:	600465795
Lloji i shoqërisë:	Organizatë Jo Qeveritare
Adresa e regjistrimit:	Rr. "Agim Ramadani" pr, Prishtinë
Kryesues i bordit të OJQ:	Zt. Armend Budima
Përfaqësues i OJQ-së:	Zt. Burhanudin Misini, Sekretar

Veprimtaria, qëllimi dhe misioni i themelimit

Qëllimet kryesore të themelimit të OJQ "FSHeK" janë:

- Federata e Shahut e Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: FSHeK) është i vetmi organ/asociacion sportive që përfaqëson bashkimin e klubeve të shahut në Republikën e Kosovës, të cilat veprojnë në përputhje me dispozitat e Ligjit për sport dhe atke tjera juridike që rregullojnë këtë veprimtari;
- Federata u themelua për të organizuar dhe promovuar shahun në Kosovë dhe përfaqësuar atë në arenën ndërkombëtare në përputhje me Ligjin, Statutin, Statutet e FIDE-s dhe ECU-s;
- Federata është person juridik i themeluar në interes të publikut. Të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë i ka të përcaktuara me ligjin për sport, me statut dhe aktet tjera normative të Federatës;
- Federata është themeluar për një periudhë të pakufizuar kohe dhe ka pavarësi të plotë organizative dhe administrative e teknike në zbatimin e veprimtarisë së saj;
- Federata është anëtare e plotë e Komitetit Olimpik të Republikës së Kosovës, si dhe organizatave ndërkombëtare të shahut si "FIDE", "ECU" dhe FRANCOFHONY.

Synimet dhe objektivat OJQ "FSHeK" janë:

- Nxiti, zhvillon, përmirëson dhe promovon sportin e shahut në Republikë e Kosovës;
- Zhvillon dhe përmirëson të gjitha nivelet e shahut tek seniorët, të rinjtë dhe të zhvillon shahun në shkolla, shahun e femrave dhe aktivitete tjera;
- Organizon dhe menaxhon garat e shahut Brenda kompetencave të saj duke zhvilluar dhe promovuar lojën e shahut në të gjitha nivelet në Republikën e Kosovës;
- Koordinon aktivitetet e anëtarëve të saj, mbron dhe respekton interes të tze si dhe arbitron në zgjidhjen e kontesteve në mes tyre;
- Organizon konferenca, seminare, kurse trajnimi dhe siguron informacionmbi aktivitetet dhe anëtarët e saj;

FEDERATA E SHAHUT E KOSOVËS

SHËNIMET E PASQYRAVE FINANCIARE

Për vitin që përfundoi më 31 dhjetor 2024

(Shumat në Euro)

- Zhvillon bashkëpunimin me organizmat ndërkombëtar dhe krijon kontakte të regullta bashkëpunimi me Fide-në dhe ECU-në, si dhe me federatat e shahut që janë anëtare të saj;
- Oranizon gara dhe aktivitete të tjera në përputhshmëri me organizatat ndërkombëtare të shahut, FIDE dhe ECU, si dhe bën organizimin e garave ndërkombëtare të shahut në përputhshmëri me planëprogramin.
- Zhvillon bashkëpunimin me organizatat tjera sportive në Kosovë si dhe promovon shahun shahun në frymën e paqës dhe të lojës së drejtë pa diskriminim mbi baza politike, etnike, gjinore, fetare, racore etj.
- Mban kontakte dhe bashkëpunon me institucionet shtetërore, sidomos në lidhje me strategjinë dhe politikat për zhvillimin e shahut dhe ato që kanë të bëjnë me legjislacionin për sportin;
- Siguron asistencë, sponzorime, donacione nga burime të ndryshme Brenda dhe jashtë vendit si dhe subvencione nga MKRS – Departmenti i Sportit.

2. Politikat e kontabilitetit

Pasqyra financiare janë përgatitur për qëllime të raportimit tek Divizioni i Raportimit Financiar i OJQ-ve në kuadër të Ministrisë së Administratës Publike.

Në vazhdim janë paraqitur politikat kryesore të kontabilitetit që janë adoptuar në përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare:

2.1. Baza e përgatitjes dhe deklarata e pajtueshmërisë

Këto pasqyra financiare janë përgatitur në përputhje me dispozitat e raportimit financiar të Neni 18 të Ligjit Nr. 03/L-134 për Lirinë e Asocimit në Organizata Joqeveritare si dhe janë përgatitur në pajtueshmëri me Standardin Ndërkombëtar të Raportimit Financiar për Ndërmarrje të Vogla dhe të Mesme (SNRF për NVM). Mbi këtë bazë të raportimit Federata e Shahut e Kosovës duhet të raportojë fondet dhe përdorimin e tyre gjatë periudhës dhe pasuritë dhe përgjegjësitë financiare të saj (neni 18, pika 6 e ligjit Nr. 03/L-134). Këto pasqyra financiare janë përgatitur në pajtueshmëri me konventën e kostos historike. Pasqyrat Financiare janë përgatitur për vitet e përfunduara me 31 dhjetor 2024 dhe vitin paraprak. Të dhënat aktuale dhe karahasuese në këto pasqyra financiare janë të shprehura në Euro, përderisa nuk ceket ndryshe. Kur është e nevojshme zërat krahasues janë harmonizuar konform ndryshimeve të vitit në prezantim.

2.2. Valuta funksionale dhe raportuese

Pasqyrat financiare janë të paraqitura në Euro, e cila është valuta funksionale e organizatës.

2.3. Paraja dhe ekuivalentet e parasë

Paraja dhe ekuivalentet e parasë përfshijnë balancet e parasë së gatshme dhe ato të depozituara në bankat vendore.

2.4. Shkëmbimet në valuta të huaja

Transaksionet në valuta të huaja janë regjistruar në pajtueshmëri me normën valide të këmbimit në datën e transaksionit. Ndryshimet janë regjistruar në pasqyrën e të ardhurave si fitime/humbje.

2.5. Kundërbalancimi (offsetting)

Pasuritë financiare dhe detyrimet janë kundërbalancuar dhe raportuar në bilancin e gjendjes atëherë kur ka të drejtë të imponueshme ligjore për të kundërbalancuar shumat e njohura dhe ka synim të vendoset në baza neto, ose të realizojë pasurinë dhe të shlyejë detyrimin në të njëjtën kohë.

2.6. Njohja e të ardhurave

Të ardhurat janë njohur atëherë kur është e mundur që benefitet e ardhshme ekonomike do të rrjedhin në Federatë dhe këto benefite të mund të maten besueshëm.

2.7. Prona, impiantet dhe paisjet

Prona, impiantet dhe paisjet janë bartur në kosto historike minus zhvlerësimi i akumuluar. Kostoja historike përfshin të gjitha shpenzimet direkt të atribueshme në përvetësimin e zëri.

Zhvlerësimi është ngarkuar duke përdorur metodën lineare në normat e paracaktuara në mënyrë që të alokohet kostoja e pronës, impianteve dhe paisjeve përgjatë jetës së tyre të përdorimit.

Në vazhdim është paraqitur jeta e përafërt e përdorimit e aplikuar ndaj zërave të rëndësishëm të pronës, impianteve dhe paisjeve:

	2024	2023
Mobiljet dhe paisjet	2-5 vite	2-5 vite
Paisjet e TI nën 1,000 Euro	3 vite	3 vite
Veturat	5 vite	5 vite

FEDERATA E SHAHUT E KOSOVËS

SHËNIMET E PASQYRAVE FINANCIARE

Për vitin që përfundoi më 31 dhjetor 2024

(Shumat në Euro)

Kostot pasuese janë përfshirë në vlerën bartëse të pasurive ose janë njohur si pasuri të ndara, si ka qenë e përshtatshme, vetëm kur është e mundur që benefitet e ardhshme ekonomike të lidhura me zërin do të rrjedhin në Federatë dhe kostoja e zërit mund të matet me besueshmëri. Të gjitha riparimet tjera dhe mirëmbajtja janë ngarkuar në pasqyrën e të ardhurave gjatë periudhës financiare në të cilën kanë ndodhur. Fitimet dhe humbjet mbi heqjet janë përcaktuar duke krahasuar shumat me vlerat bartëse. Këto janë përfshirë në pasqyrën e të ardhurave.

2.8. Pasuritë e paprekshme

Pasuritë e paprekshme me jetëgjatësi të caktuar të cilat janë blerë veç e veç mbahen me kosto minus amortizimi i akumuluar dhe humbjet e akumuluar nga dëmtimi. Amortizimi njihet në baza të njejta përgjatë jetëgjatësisë së vlerësuar të pasurisë.

Pasuritë e paprekshme të Federatës përmbajnë Softuerë kompjuterik.

Amortizimi është ngarkuar duke përdorur metodën drejtvizore brenda pesë viteve përgjatë jetës së tyre të përdorimit.

2.9. Grantet

Grantet e Qeverisë njihen në fitim ose humbje në baza sistematike përgjatë periudhës në të cilën Federata i njeh si shpenzime kostot përkatëse për të cilat grantet janë destinuar për kompenzim. Në mënyrë specifike grantet e Qeverisë, për të cilat kushti primar është që Federata duhet të i përfitoj, konstruktoj apo të i njeh pasuritë jo-qarkulluese si të hyra të shtyra në pasqyrën e pozitës financiare dhe të transferohen në fitim apo humbje në baza sistematike dhe racionale përgjatë jetës së përdorimit të pasurisë përkatëse.

Grantet janë njohur vetëm kur ka siguri të arsyeshme se:

- Federata do të përmbushë të gjitha kushtet e bashkangjitura atyre; dhe
- Grantet do të pranohen.

Grantet operative janë njohur si e hyrë përgjatë periudhës së nevojshme për ti lidhur ato me kostot, për të cilat janë menduar të kompensohen, në bazë sistematike. Grantet e shënuara për përvetësimin e pasurive janë shtyrë dhe njohur si e hyrë përgjatë kohës së përdorimit të pasurisë përkatëse.

2.10. Stokset

Stokset janë prezantuar me vlerën më të ulët ndërmjet kostos dhe çmimit të shitjes minus kostot e kompletimit dhe shitjes.

2.11. Llogaritë e arkëtueshme dhe të tjera

Shumica e shitjeve janë bërë në bazë të afateve normale të kreditimit, si dhe llogaritë e arkëtueshme nuk bartin interes. Ku kreditimi është zgjatur përtej afateve normale të kreditimit, llogaritë e arkëtueshme maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv. Të arëktueshmet tregtare të shprehura në monedhë të huaj shprehen në valutën Euro duke përdorur kursin e këmbimit në datën e raportimit.

Në fund të çdo periudhe raportuese, vlerat kontabël të llogarive të arkëtueshme tregtare dhe të tjera shqyrtohen për të përcaktuar nëse ka ndonjë evidencë objektive që shumat nuk janë të rikuperueshme. Nëse është kështu, një humbje nga dëmtimi (rënia në vlerë) njihet menjëherë në pasqyrën e të ardhurave.

2.12. Llogaritë e pagueshme dhe të tjera

Llogaritë e pagueshme tregtare janë detyrime në bazë të afateve normale të kreditimit dhe nuk bartin interes. Të pagueshmet tregtare të shprehura në monedhë të huaj shprehen në valutën Euro duke përdorur kursin e këmbimit në datën e raportimit. Fitimet ose humbjet e këmbimit valutor janë të përfshira në të ardhurat e tjera apo shpenzimet e tjera.

2.13. Kreditë bankare dhe mbitërheqjet

Shpenzimet e interesit regjistrohen në bazë të metodës së interesit efektiv dhe përfshihen në shpenzimet financiare.

2.14. Shpenzimet

Shpenzimet janë njohur kur kanë ndodhur.

2.15. Benefitet e të punësuarve

Federata kontribon në planet pas pensionale të të punësuarve të saj siç përshkruhen nga legjislacioni i sigurimit i miratuar nga ligjet në fuqi në Republikën e Kosovës. Kontributet, e bazuara në paga, u janë bërë organizatës nacionale që janë përgjegjëse për pagesën e pensioneve. Nuk ka detyrim shtesë në lidhje me këto plane dhe kështu këto skema janë konsideruar si plane të definuara të kontributeve. Federata nuk ka benefite pas pensionale ndaj të punësuarve të saj.

2.16. Tatimi në fitim

Federata është krijuar si organizatë jo profitabile dhe prandaj, është e liruar nga tatimi në të ardhura të korporatave. Federata gjatë vitit 2024 nuk ka gjeneruar të hyra tjera nga aktivitetet ekonomike të cilat i nënshtrohen tatimit në të ardhura të korporatave.

Federata nuk ka njohur ndonjë detyrim apo pasuri të shtyrë tatimore me 31 Dhjetor 2023, siç nuk ka ndryshime të përkohshme ekzistuese në ato data.

3. Të hyrat

Të ardhurat prezantojnë të hyrat nga grantet, donacionet, anëtarësia dhe aktivitetet ekonomike dhe më datë më 31 Dhjetor 2024 përbëhen si më poshtë:

	për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2024	për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2023
Të hyrat nga MKRS	138,510	137,568
Të hyrat nga FIDE	3,140	5,000
Të hyrat nga antaresia	4,020	1,500
Te hyrat nga donacionet/projektet	-	28,087
Te hyrat nga sponsorizimi	-	56,000
Të hyrat tjera	15,290	-
Gjithsej	160,960	228,156

4. Shpenzimet e personelit

Shpenzimet e personelit prezantojnë shpenzimet direkte dhe indirekte për zhvillimin dhe mbarrëvajtjen e projekteve përgjatë periudhës 1 Janar deri më 31 Dhjetor 2024 të cilat përbëhen nga si më poshtë:

	për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2024	për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2023
Pagat dhe mëditjet bruto	11,593	5,400
Kontributet pensionale të punëdhënësit	580	270
Gjithsej	12,172	5,670

5. Shpenzimet administrative dhe operative

Shpenzimet e administrative dhe operative prezantojnë shpenzimet e tarifave bankare, anëtarisë, pajisjeve të vogla, udhëtimit dhe derivateve, konsulencës dhe shpenzimeve tjera në mbështetje të mbarrëvajtjes së projekteve të zhvilluara nga organizata përgjatë periudhës 1 Janar deri më 31 Dhjetor 2024 që përbëhen nga si më poshtë:

	për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2024	për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2023
Shpenzimet antarësisë	20,507	3,301
Shpenzimet bankare	1,599	697
Shpenzimet e zyres dhe administratës	15,508	1,632
Shpenzime telefonit	150	216
Shpenzime për udhëtime dhe transport	2,565	436
Shpenzimet e konsulencës	3,300	3,000
Shpenzimet e asete të vogla/garnitura	15,547	1,443
Shpenzimet e trajnimeve	3,500	1,500
Shpenzimet tjera	4,524	12
Gjithsej	67,199	12,237

6. Shpenzimet për organizimin e garave

Shpenzimet për organizimin e garave prezantojnë shpenzimet për të mbështetur operacionet dhe mbarrëvajtjen e projekteve të zhvilluara nga organizata përgjatë periudhës 1 Janar deri më 31 Dhjetor 2024, që përbëhen nga si më poshtë:

	për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2024	për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2023
Ushqim dhe pije	12,586	8,980
Akomodim	36,861	25,504
Certifikata, kupa dhe medalje	3,232	1,741
Mirënjohje, banera dhe flyers	6,890	2,397
Mëditje	12,035	2,750
Referim	8,394	4,936
Qiraja e salles	11,650	7,414
Transport për gara	13,875	3,259
Viza aplikime dhe sigurime	216	667
Derivate për gara	1,939	1,336
Të tjera	4,108	673
Gjithsej	111,787	59,656

7. Shpenzimet për shpërblime dhe klube rajonale

Shpenzimet e shpërblimeve janë shpenzime në lidhje shpërblimet e pjesëmarrësve në garat e ndryshme të mbajtura nga FSHK. Shpenzimet për klube rajonale janë dhënë si mbështetje për klube nga Qeveria e Kosovës (MKRS).

	për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2024	për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2023
Ekipore	27,325	36,288
Individuale	6,000	11,170
Gjithsej	33,325	47,458

8. Shpenzimet e promovimit të shahut

	për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2024	për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2023
Shpenzimet e promovimit të shahut	-	20,650
Gjithsej	-	20,650

9. Shpenzimet e sponsorizimit-BpB

	për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2024	për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2023
Shpenzimet e sponsorizimit	-	15,053
Gjithsej	-	15,053

FEDERATA E SHAHUT E KOSOVËS
SHËNIMET E PASQYRAVE FINANCIARE
Për vitin që përfundoi më 31 dhjetor 2024
(Shumat në Euro)

10. Paraja dhe ekuivalentët e parasë

Mjete monetare dhe ekuivalente me to më 31 dhjetor 2024 janë si me poshtë:

	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Paraja në arkë	4	49
Paraja në bankë - RBKO	37	58,747
Paraja në bankë - IS BANK	912	-
Gjithsej	953	58,796

11. Llogaritë e pagueshme

Llogaritë e pagueshme me datë 31 dhjetor 2024 janë paraqitur si më poshtë:

	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
B FINANCIAL SHPK	600	-
BALLKAN YOUTH ONLINE	100	100
BESA SECURITY	1,250	1,250
EUROPEAN CHESS UNION	8,076	5,580
GJYKATA THEMELORE PRISHTINE	1,469	-
HOTEL ARXHENA	3,500	3,500
KOMITETI OLIMPIK I KOSOVES (KOK)	5,000	5,000
PRODUKSIONI NATYRA FILM	500	500
SLOVENIAN CHESS FEDERATION	900	-
TURKISH CHESS FEDERATION	5,760	5,760
Tjera	2,000	1,013
Gjithsej	29,154	22,703

12. Detyrimet afatshkurtra

Detyrimet tjera afatshkurtëra me datë 31 dhjetor 2024 janë paraqitur si më poshtë:

	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Detyrimet ndaj ATK	77	2,431
Detyrimet ndaj pagave neto	584	-
Huazimet afatshkurtëra	3,550	2,550
Gjithsej	4,212	4,981

13. Zotimet dhe kontigjencat

Zotimet

Nuk ka zotime me 31 Dhjetor 2024. Federata nuk paguan qera pasi shfrytëzon zyren në hapësirat e Federatave të Kosovës.

Çështjet gjygjësore

Me 31 Dhjetor 2024 nuk është llogaritur asnjë provizion për humbjet potenciale në lidhje me çështjet gjygjësore. Menaxhmenti i FSHeK-së, rregullisht analizon rreziqet potenciale që rezultojnë nga humbjet në lidhje me proceset gjygjësore dhe predendimet e mundshme kundër FSHeK-së, të cilat mund të dalin në të ardhmen. Edhe pse rezultati i këtyre çështjeve nuk mundet gjithëmonë të saktësohet, menaxhmenti i FSHeK-së beson se nuk ka gjasë që të rezultojë ndonjë detyrim material.

14. Ngjarjet pas datës së raportimit

Nuk ka ndonjë ngjarje pas datës së raportimit që kërkon korigjim ose shpalosje në pasqyrat financiare.